



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 115 /2024

Dt. 10 / 05 / 2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr.06/113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 27 (paragrafi 7) të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në bazë të nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores së QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në bazë të propozimeve të përfaqësuesve nga Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale dhe propozimeve nga KOMF, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Paneli për Adoptim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me këtë përbërje:
 - 1.1. Ruzhdi Osmani, Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit të Politikave të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Kryesues,
 - 1.2. Magbule Koci, Zyrtare e Lartë për Mbrojtjen e fëmijëve të braktisur, anëtare,
 - 1.3. Nafije Selimi, zyrtare e lartë për sanimin e marrëdhënieve familjare dhe kontaktim, anëtare,
 - 1.4. Agim Mala, udhëheqës i shërbimit në QPS Pejë, anëtar,
 - 1.5. Burim Behluli, Drejtor i Programit në SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, anëtar.

2. Mandati i anëtarëve të Panelit për Adoptim zgjatë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Obligohet Paneli që detyrat dhe përgjegjësitë t'i kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Me këtë vendim, shfuqizohet vendimi nr. 138/2023, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin nr. 176/2023 i datës 04.09.2023.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Bazuar në ndryshimet ligjore me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare është ndryshuar edhe përbërja e Panelit për Adoptim konform nenit 27 (paragrafi 7) të këtij Ligji me tre (3) anëtarë nga Departamenti përkatës dhe sipas propozimeve të pranuara nga një (1) përfaqësues i QPS dhe një (1) përfaqësues të OJQ, është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi iu dërgohet :

- Kabinetit të Ministres së MD-së;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme të MD-së;
- Anëtarëve të Panelit për Adoptim;
- DPShSMF/MD; dhe
- Arkivit të MD-së.